



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr. 252, datë 12.11.2019

### PËR

### SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}, PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS, PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e dates 12.11.2019, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për skualifikimin e kandidatit z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020,

## V Ë R E N

### I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

- a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 01.04.2019, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit);
- b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit, duke u përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr. 11, datë 15.05.2019, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr. 1588 prot., datë 27.05.2019 (protokolluar me nr. 2898 prot., datë 27.05.2019).

2. Me Vendimin nr. 83, datë 05.06.2019, mbështetur në nenin 32 të Ligjit të Statusit, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit

të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës për kandidatët për magistratë, profili gjyqtarë, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} si relatore u caktua znj. Marçela Shehu.

3. Më datë 11.06.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua :

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit tre ditor, kandidati, z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 14.06.2019, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit, z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati, z. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datat 25.06.2019 dhe 28.06.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, pas kërimit dhe dhënies nga kandidati, në rrugë elektronike, të të dhënave të punësimit, më datë 01.07.2019, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion nga subjektet shtetërore dhe privatë që kanë mbikqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, të

cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin {...}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 05.11.2019, relatorja e parashtrori çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen me datë 05.11.2019 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatit {...} për në formimin fillestar për magistrat (profili gjyqtar) në Shkollës së Magjistraturës.

## **II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS**

### **A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat**

1. Sa i përket kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, përfshirë edhe për kandidatin {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30<sup>1</sup> (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 01.04.2019, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.

---

<sup>1</sup> “1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti.

2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kritereve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve, nuk është i plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit.

3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij.

5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe aktet nënligjore përkatëse”.

2. Gjithsesi, për kandidatin {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

2.1 Për këtë është mbajtur në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2019), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kriterëve nga ana e tyre (1 Prill 2019), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2019). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kriterëve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

2.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”)<sup>2</sup>, pika 4, shkronja “c”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në

---

<sup>2</sup> 1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë dhe figurës.

2. Brenda një jave nga publikimi i listës përfundimtare, sipas nenit 31, të këtij ligji, për secilin kandidat të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë.

3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre.

**4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur:**

a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asetë ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të asetëve;

b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar";

c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit.

5. Deri në datën 5 shtator të çdo viti, Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

6. Kandidatët kanë të drejtë të njihen me dosjen dhe të ankohen në gjykatën kompetente ndaj vendimit të Këshillave, brenda 5 ditëve. Gjykata kompetente vendos për ankimin, brenda dy javëve nga paraqitja e tij.

7. Pas përfundimit të verifikimit të pasurisë dhe figurës, Këshillat miratojnë dhe publikojnë në fund të muajit shtator të çdo viti, listën përfundimtare të kandidatëve magjistratë, që pranohen në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar trevjeçar, në përputhje me numrin e kandidatëve të përcaktuar sipas nenit 29 dhe duke respektuar me përpikëri renditjen e kandidatëve në listën e parashikuar në pikën 2, të nenit 31, të këtij ligji.

formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kriterëve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra, ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

3. Konkretisht, për kandidatin {...} u verifikua :

a) *pasja nga ai i zotësisë së plotë për të vepruar*, ku për këtë nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) *pasja e shtetësisë shqiptare*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti Letërnjoftim ID, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 17.02.2009, ku pasqyrohet përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare për këtë kandidat;

c) *gjendja gjyqësore*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, ky i fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), duke printuar në letër Çertifikatë Elektronike datë 28.02.2019, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administruan Shkresa nr. V-2125/1 prot., datë 04.07.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) *disiplina në punë*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar shkresa datë 01.08.2014 lëshuar nga “KESH SECURITY” SH R S F sh.a dhe vërtetimi datë 25.02.2019, lëshuar nga Përmbartuesi Gjyqësor Privat {...}. Ndërkohë që gjatë verifikimit u administrua shkresa datë 18.07.2019 nga “KESH SECURITY” SH R S F sh.a, shoqëruar me praktikën përkatëse; shkresa datë 17.07.2019 nga Agjencia e Trajtimit të Pronave Tiranë shoqëruar me praktikën përkatëse, si dhe shkresa datë 18.10.2019 nga Përmbartuesi Gjyqësor Privat {...}. Nga këto dokumente rezulton se kandidati është larguar nga puna nga Agjencia e Kthimit dhe e Kompensimit të pronave dhe nga “KESH SECURITY” SH R S F sh.a.

Me qëllim verifikimin e shkaqeve të largimit të kandidatit, z. {...} nga puna, u kërkua informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vënia në dispozicion e kopjes së vendimeve gjyqësore si më poshtë :

- 1- *Vendimi gjyqësor civil nr. {...} datë 23.09.2013 që i përket palës paditëse {...} dhe palës së paditur ish AKKPronave*
- 2- *Vendimi gjyqësor civil nr. {...} datë 25.03.2015 që i përket palës paditëse {...} dhe palës së paditur “KESH Security sh.r.s.f” sh.a*

Gjithashtu u kërkua informacion nëse ndaj vendimeve të mësipërme është ushtruar ankim dhe nëse po, vënia në dispozicion e kopjes së vendimeve gjyqësore të dhëna nga Gjykata e Apelit apo Gjykata e Lartë.

Nga informacioni i ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi se :

- *shtetasi {...} ka paraqitur kërkesë padi me objekt dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi ish Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë.*  
*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. {...} datë 23.09.2013 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Ky vendim është ankimuar dhe pas deklarimit të moskompetencës nga Gjykata e Apelit Tiranë, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. {...} datë 23.09.2013 ka vendosur lënien në fuqi të tij.*
- *shtetasi {...} ka paraqitur kërkesë padi me objekt deklarimin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit në mënyrë të njëanshme, me efekt të menjëhershëm për shkaqe të shkaqe të pajustificuara. dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi “KESH Security sh.r.s.f sh.a” Tiranë.*  
*Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. {...} datë 25.03.2015 ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë. Ky vendim është ankimuar dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. {...} datë 26.11.2015 ka vendosur ndryshimin e tij dhe rrëzimin e padisë duke arsyetuar se zgjidhja e kontratës së punës nga pala e paditur është bërë në përputhje me ligjin, pasi nga ana e saj është respektuar afati i njoftimit i parashikuar në nenin 141 të K.Punës, dispozitë ligjore e cila e lejon zgjidhjen e kontratës së punës nga njëra palë nëse respektohet afati i njoftimit. Në këto rrethana Gjykata e Apelit Tiranë ka çmuar se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet të ndryshohet në tërësi duke vendosur rrëzimin e padisë, si e pabazuar në ligj e në prova.*
- ***Në analizë të këtij informacioni dhe të vendimeve gjyqësore të sipërcituara, rezulton se largimi nga puna i kandidatit nuk është bërë për shkaqe disiplinore.***

d) *qënia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaroi se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qënien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

4. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) *pasjen e kriterit arsimor*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti “Diplomë”, me nr. {...}, datë 20.07.2010, lëshuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë, si dhe Çertifikatë e Notave datë 20.07.2010, lëshuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti i Drejtësisë;

b) *pasjen e përvojës profesionale*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar dokumenti “Librezë Punë”, sipas të cilit kandidati ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë si inspektor jurist pranë Agjensisë së Trajtimit të Pronave për periudhën 24.03.2011 – 27.03.2013, si specialist jurist pranë “KESH SECURITY” SHRSF sh.a për periudhën 24.05.2013 – 15.09.2014, si jurist pranë Përmbartuesit Gjyqësor Privat {...} për periudhën 05.07.2016 – 31.07.2016, 07.12.2016 - ....., 14.06.2017 – 15.12.2018;

c) *mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk është anëtar i ndonjë partie politike;

ç) *mosqënien anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990*, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së tij (i datëlindjes {...}), ai nuk mund të ketë qenë i tillë.

5. Për sa më sipër, rezulton që kandidati për në formimin fillestar {...} plotëson kriteret e përgjithshme e të veçanta për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, në kuptim të nenit 28 të ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë."

## **B. Për kriterin e pasurisë sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit**

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor **Raportin nr. 46/29 prot., datë 19.08.2019.**

2.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

2.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin ka rezultuar :

- *Deklarim i pasaktë lidhur me burimin financiar që ka shërbyer për dhënien e huasë në muajin mars 2015 në shumën totale 2.000.000 lekë, pasi ndër të tjera, si burim është deklaruar ekzekutimi i vendimit të gjykatës për dëmshperblim page, por rezulton se ky ekzekutim është bërë 3 muaj pas dhënies së huasë.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar të huasë së dhënë në muajin mars 2015 shtetasve {...}, {...} dhe {...} në shumën 2.000.000 lekë, pasi të ardhurat e ligjshme të deklaruara dhe dokumentuara, deri në momentin e dhënies së huasë, rezultojnë rreth 2.430.000 lekë. Nga kjo shumë nuk janë zbritur shpenzimet jetike dhe as automjeti i blerë 4.100 Euro në Maj 2013.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me huanë e dhënë shtetasve {...} në shumën 5.000 Euro dhe burimin e saj.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar deklarin e kandidatit për bashkëpjesëmarrje në investimin në Bono Thesari, pasi nga sa është paraqitur dhe konfirmuar nga bankat, rezulton vetëm në emër të {...}. Gjithashtu, mbetet i paqartë identiteti i personit tjetër, i cili ka investuar pjesën tjetër në blerjen e bonove të thesarit dhe burimi financiar i tij.*
- *Mbetet i paqartë burimi financiar i shumës prej 2.500.000 lekë të kredituar nga shtetasi Ndue {...} (babai) në llogarinë e kandidatit {...} dhe destinacioni i përdorimit*

të saj. DPPP konfirmon se në datë 19.06.2015, kandidati i ka dhënë hua shtetasve {...}, {...}dhe {...}, në shumën prej 20.000 Euro.

- Nuk është e qartë nëse huaja e dhënë nga kandidati shtetasve {...}, {...} dhe {...}, në datë 19.06.2015 (konfirmuar nga DPPP) është shlyer nga ana e tyre, pasi nga dokumentacioni i administruar, nuk rezulton kthim i pjesshëm apo i plotë i saj, por në Deklaratën e Interesave Private, kandidati nuk ka deklaruar “hua apo detyrim të mbetur të shtetasve {...}, {...}dhe {...}”.
- Mbetet i paqartë burimi financiar i shtetasit {...} për dhënien e huasë shtetasit {...} në datë 08.01.2016, në shumën 4.255.000 lekë (konfirmuar nga DPPP), qëllimi i huadhënies dhe mënyra e kthimit të saj, pasi referuar Deklaratës Noteriale Nr. 243 Rep, Nr. 67 Kol, datë 05.03.2018, citohet se 2.114.400 lekë është likujduar pjesë-pjesë gjatë vitit 2017 dhe diferenca tjetër në vlerën 15.400 Euro, nëpërmjet kontratës për kalim të drejtash Nr. {...} Rep, Nr. {...} Kol, datë 05.03.2018.
- Nuk është e qartë nëse huaja e dhënë nga kandidati shtetasit {...}, sipas deklaratës datë 12.01.2016 (konfirmuar nga DPPP) është shlyer nga ana e tij, pasi në Deklaratën e Interesave Private, kandidati nuk ka deklaruar “hua apo detyrim të mbetur shtetasit {...}”, gjithashtu edhe nga dokumentacioni i administruar nuk rezulton kthim i pjesshëm apo i plotë i saj.
- Janë të paqarta transaksionet në llogaritë bankare në emër të kandidatit {...} dhe lidhja e tij me personat e përfshirë në transaksione.
- Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se kandidati ka kryer transaksione të vazhdueshme në vlera relativisht të larta në marrjen dhe dhënien e huave dhe nuk është i qartë qëllimi i kryerjes së tyre. Referuar datave të kontratave, gjykohet përgjithësisht se kandidati merr hua për të dhënë hua, por gjithësesi burimi mbetet i paqartë dhe i pajustificuar me dokumentacionin ligjor.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, date 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...} :

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të vëllezërve dhe motrës në emigracion, si burim për huadhënie e shpenzime të ndryshme;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.3 Më datë 28.08.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Kreu IX, Seksionin A, pika 11, shkronja b, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për përfundimin e raportit të ILDKPKI-së, raport ky që i është bashkëngjitur njoftimit;
- për të drejtën që kishte për të paraqitur shpjegime dhe dokumenta të tjera përpara Këshillit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

2.4. Brenda afatit ligjor, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin e ILDKPKI-së duke i shoqëruar me dokumentacionin përkatës.



2.5 Me shkresën nr. 3210/3 prot., datë 02.09.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i ka dërguar ILDKPI-së, kërkesë për informacion shtesë në lidhje me kandidatin për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës z. {...}, duke i përcjellë dhe dokumentacionin përkatës.

2.6 Me shkresën nr. 3914/1 prot., datë 23.09.2019, ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor **raportin nr. 46/30 datë 23.09.2019**, duke konkluduar për kandidatin z. {...} :

- *Mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar deklarin e kandidatit për bashkëpjesëmarrje të prindërve në investimin në Bono Thesari, pasi nga sa është paraqitur dhe konfirmuar nga bankat, rezulton vetëm në emër të {...}.*
- *Mbetet i padokumentuar qëllimi i përdorimit të shumës prej 2.500.000 lekë, të kredituar nga shtetasi {...} (babai) në llogarinë e kandidatit {...}, i cili ka sqaruar se është përdorur për shpenzime të ndryshme, jo asete. Kandidati nuk është i sigurtë nëse është përdorur ose jo për dhënie huaje.*
- *Mospërputhje e burimit financiar të shtetasit {...} për dhënien e huasë shtetasit {...} në datë.08.01.2016, në shumën 4.255.000 lekë, konfirmuar nga DPPP nga puna në ndërtim e huadhënësit, ndërsa referuar kandidatit është nga aktiviteti i tij blegtoral dhe shitja e tokës dhe e kafshëve të imta. Mungesë dokumentacioni lidhur me burimin financiar të huadhënësit.*
- *Mosparaqitje e dokumentacionit të plotë justifikues ligjor për burimin financiar të vëllezërve dhe motrës në emigracion (përveç të ardhurave nga paga e tij dhe e babait), që ka shërbyer për transaksione të kryera prej kandidatit për shpenzime huadhënie.*

*Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...};*

- a) *deklarin nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e transaksioneve;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarin të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.7 Më datë 26.09.2019, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, i njohur me materialet dhe referuar gjetjes në procedurën e verifikimit të pasurisë, sipas përcaktimeve të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Seksionit A, Kreu IX të Vendimit nr. 75 datë 23.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” ka vendosur mbi njoftimin e kandidatit {...} mbi gjetjen e procedurës së verifikimit, lidhur me kriterin e pasurisë, duke e ftuar për të paraqitur shpjegime si dhe çdo dokumentacion mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të tij, duke konsideruar gjetje konstatimet e përcaktuara në raportin e sipërcituar të ILDKPI-së dhe konkretisht:

- *Mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar deklarin e kandidatit për bashkëpjesëmarrje të prindërve në investimin në Bono Thesari, pasi nga sa është paraqitur dhe konfirmuar nga bankat, rezulton vetëm në emër të {...}.*
- *Mbetet i padokumentuar qëllimi i përdorimit të shumës prej 2.500.000 lekë, të kredituar nga shtetasi {...} (babai) në llogarinë e kandidatit {...}, i cili ka sqaruar se është përdorur për shpenzime të ndryshme, jo asete. Kandidati nuk është i sigurtë nëse është përdorur ose jo për dhënie huaje.*
- *Mospërputhje e burimit financiar të shtetasit {...} për dhënien e huasë shtetasit {...} në datë. 08.01.2016, në shumën 4.255.000 lekë, konfirmuar nga DPPPP nga puna në ndërtim e huadhënësit, ndërsa referuar kandidatit është nga aktiviteti i tij blegtoral dhe shitja e tokës dhe e kafshëve të imta. Mungesë dokumentacioni lidhur me burimin financiar të huadhënësit.*
- *Mosparaqitje e dokumentacionit të plotë justifikues ligjor për burimin financiar të vëllezërve dhe motrës në emigracion (përveç të ardhurave nga paga e tij dhe e babait), që ka shërbyer për transaksione të kryera prej kandidatit për shpenzime huadhënie.*

2.8. Me datë 01.10.2019, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin e dytë të ILDKPKI-së duke i shoqëruar me dokumentacionin dhe argumentat përkatës.

2.9 Me shkresën nr. 3788/19 prot., datë 02.10.2019, pas paraqitjes së shpjegimeve dhe dokumentacionit shtesë nga kandidati, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i ka dërguar sërish kërkesë ILDKPI-së, për informacion shtesë në lidhje me kandidatin për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës z. {...}, duke i përcjellë dhe dokumentacionin përkatës, me qëllim rikonsiderimin e përfundimeve të raportit të kontrollit të pasurisë.

2.10 Me shkresën nr. 3332/12 prot., datë 09.10.2019, ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin përfundimtar me **nr.46/31 prot, datë 09.10.2019**, duke konkluduar se për kandidatin z. {...} rezulton :

- *Mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar deklarin e kandidatit për bashkëpjesëmarrje të prindërve në investimin në Bono Thesari, pasi nga sa është paraqitur dhe konfirmuar nga bankat, rezulton vetëm në emër të {...}.*
- *Mbetet i padokumentuar qëllimi i përdorimit të shumës 2.500.000 lekë, të kredituar nga shtetasi {...} (babai), në llogarinë e kandidatit {...}, i cili ka sqaruar se është përdorur për shpenzime të ndryshme, jo asete. Kandidati nuk është i sigurtë nëse është përdorur ose jo për dhënie huaje.*
- *Mospërputhje e burimit financiar të shtetasit {...} për dhënien e huasë shtetasit {...} në datë 08.01.2016 në shumën 4.255.000 lekë, konfirmuar nga DPPPP nga puna në ndërtim e huadhënësit, ndërsa referuar kandidatit është nga aktiviteti i tij blegtoral dhe shitja e tokës dhe kafshëve të imta. Mungesë dokumentacioni lidhur me burimin financiar të huadhënësit.*
- *Mosparaqitje e dokumentacionit të plotë justifikues ligjor për burimin financiar të vëllezërve dhe motrës në emigracion (përveç të ardhurave nga paga e tij dhe e babait) që ka shërbyer për transaksione të kryera prej kandidatit për shpenzime e huadhënie.*

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, date 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...} :

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin financiar të vëllezërve dhe motrës në emigracion, si burim për huadhënie e shpenzime të ndryshme;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.11 Më datë 15.10.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Kreu IX, Seksionin A, pika 11, shkronja b, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua :

- për përfundimin e raportit të ILDKPKI-së, raport ky që i është bashkëngjitur njoftimit;
- për të drejtën që kishte për të paraqitur shpjegime rreth këtij raporti

2.12. Kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me raportin e ILDKPKI-së duke argumentuar si më poshtë :

*“Pasi u njoha më përmbajtjen e raportit (aktin e përfundimit të kontrollit të plotë), konstatoj se në vijim raporti nuk është i saktë, ka natyrën e një hetimi administrativ sipërfaqësor/keqdashës, (sikurse raportet paraardhëse), vjen si rezultat i një procedimi administrativ të pabazuar në legjislacionin në fuqi dhe nuk përmbush as në kufijtë minimal obligimet e ngarkuara nga legjislacioni në fuqi i ILDKPKI-së, mbi ushtrimin e procedimit administrativ në përputhje me ligjin 9049/2003 dhe me të drejtat/garancitë e parashikuara nga legjislacioni në fuqi i detyrueshëm për t’u zbatuar/respektuar prej saj, si dhe çënon thellësisht standartin kushtetues të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, çënon thellësisht pavarësinë e pushtetit gjyqësor (gjyqtarit) parashikuar nga neni 145/1.*

Ligji nr. 9049/2003, në nenin 4 të tij ka parashikuar se çfarë është objekt deklarimi dhe që janë:

- a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to;
- b) pasuritë e luajtshme, të regjistrueshme në regjistrat publikë;
- c) sendet me vlerë të veçantë mbi 300 000 (treqindmijë) lekë;
- ç) vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim;
- d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj;
- dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj;
- e) të ardhurat personale për vitin, nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale;
- ë) licencat dhe patentat që sjellin të ardhura.
- f) dhuratat dhe trajtimet preferenciale, përfshirë identitetin e personit fizik ose juridik, prej nga vijnë apo krijohen dhuratat a trajtimet preferenciale. Nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe kur dy e më

shumë dhurata ose trajtime preferenciale, të dhëna nga i njëjti person, së bashku, nuk e kalojnë këtë vlerë, gjatë së njëjtës periudhë deklarimi;

g) angazhime në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, përfshirë çdo lloj të ardhure, të krijuar nga kjo veprimtari ose ky angazhim;

gj) interesa privatë të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës;

h) çdo shpenzim i deklarueshëm, me vlerë mbi 300 000 (treqind mijë) lekë, i kryer gjatë vitit të deklarimit.

Në të tre raportet e kontrollit të deklaratës së pasurisë ka rezultuar që ILDKPKI, ka arritur në konkluzionin se nuk rezulton që të ketë ndonjë deklarim të rremë ose që të ketë fshehur pasuri, ndonjë nga llojet e sendeve të cilat janë objekt deklarimi.

Ligji në vijim në nenin 5, parashikon deklarimin para fillimit të detyrës në të cilën parashikohet se deklarohen : **"a) të gjitha pasuritë e grumbulluara**, detyrimet financiare dhe interesat e tjerë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, përfshirë burimet e krijimit të tyre; **b) angazhimet në veprimtari private** me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura, që ekzistojnë në datën e fillimit të punës, përfshirë çdo lloj të ardhure të krijuar nga këto angazhime ose veprimtari, nga data 1 janar deri në datën e fillimit të punës të vitit të deklarimit.

Pra, bazuar në nenin 5 rezulton se duhet deklaruar në deklaratën e pasurisë dhe interesave private:

1. Të gjitha pasuritë e grumbulluara (që ekzistojnë në momentin e deklarimit)
2. Detyrimet financiare (që ekzistojnë në momentin e deklarimit)
3. Interesat e tjerë të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji (që ekzistojnë në momentin e deklarimit)

Nëse ndalemi dhe analizojmë pasurinë e një personi, ajo në vetvete është te gjitha të drejtat dhe detyrimet e një personi me natyrë/vlerë ekonomike. Të drejtat dhe detyrimet e një personi ndryshojnë vazhdimisht ato nuk janë në një moment të caktuar dhe të vazhdojnë të jenë identike në formë dhe përmbajtje gjithmonë (në vijueshmëri). Kjo sepse vazhdimisht individit shton dhe /ose pakëson të drejtat dhe/ose detyrimet e tij. Nga kjo rrjedh se pasuria është një koncept dinamik dhe se ajo është e lidhur ngushtësisht me momentin kohor të caktuar.

Prandaj dhe ligji 4090/2003, kërkon deklarimin e pasurisë së **grumbulluar** dhe detyrimeve të **akumuluar** që ekzistojnë në **momentin e deklarimit**. Pra është vetë ligji i cili deklarimin e pasurisë e lidh me një moment të caktuar kohor, atë të datës së deklarimit. Në të tre raportet e përgatitura nga ILDKPKI rezulton :

✓ Se janë deklaruar të gjitha pasuritë e **grumbulluara** (që ekzistojnë në momentin e deklarimit), datë 05.07.2019, (raporti nuk konstaton ndonjë pasuri të padeklaruar)

✓ Të gjitha detyrimet financiare (që ekzistojnë në momentin e deklarimit) datë 05.07.2019 (raporti nuk konstaton ndonjë detyrim të padeklaruar)

✓ Interesat e tjera nga ato që përmenden në nenin 4 të ligjit sipërpërmendur ne (që ekzistojnë në momentin e deklarimit) datë 05.07.2019, (raporti nuk konstaton ndonjë nga interesat që parashikohen në nenin 4)

Është e vërtetë që ka pasur një lapsus/gabim material lidhur me referimin e vendimit gjyqësor nr. {...} datë 02.07.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, dëshmipërblim page, si burim për aktin noterial nr. {...} rep, {...} kol, datë 25.03.2015 para noterit publik {...}, por ky një gabim/lapsus material, i cili siç rezulton dhe në dy raportet e ILDKPKI-së, nuk është konsideruar si i tillë duke mos ndikuar në saktësinë e deklaramit.

Rezulton, referuar si deklaratës së pasurisë dhe interesave private ashtu edhe raporteve të ILDKPKI-së, se pasuria neto në datën e deklaramit (05.07.2019), është në vlerën rreth 1.738.000 lekë, të ardhurat e ligjshme (të formalizuara) janë në vlerën 3.791 000 lekë. Me një llogaritje të thjeshtë të ardhurat janë në vlerën e më shumë së dyfishi i pasurisë së akumuluar në momentin e deklaramit.

Duke qenë të ardhurat më shumë se dyfish është mëse e qartë që pasuria e kandidatit është/rrjedh nga burime të ligjshme. ILDKPKI duke shmangur përgjegjësinë e saj ligjore për të dalë në konkluzion bazuar në të dhënat e deklaratës së pasurisë, ka shpërdoruar diskrecionin e lartë që i jep ligji për të arritur në një konkluzion të pabazuar në ligj.

Qëllimi i ligjvënësit nuk është që duke i bërë kandidatët për magjistratë subjekt të deklaramit që në fazën e hyrjes në Shkollën e Magjistraturës të formalizojë me efekte prapavepruese Ekonominë Shqiptare apo aq më pak ekonominë e Mbretërisë së Bashkuar.

Ka vetëm një qëllim (të ligjvënësit) që kandidatët (nga momenti i kualifikimit në provimin hyrës në Shkollën e Magjistraturës dhe deri në datën e emërimit si Magjistratë, një hark kohor rreth 3 vjet,) duke parashikuar të ardhmen si magjistratë të mos abuzojnë duke shtuar në mënyrë artificiale pasurinë e tyre në deklaramin fillestar (para fillimit të shkollës), duke krijuar kështu premisa për abuzimin me detyrën prej tyre, në kohën në vijim gjatë ushtrimit të detyrës si Magjistratë.

Ndaj në një zbatim të saktë të qëllimit të ligjvënësit, kujdesi kryesor duhet treguar që të shmangët fryrja e pasurisë së kandidatëve nga data e shpalljes si fitues në provimin e rekrutimit e në vijim deri në datën e emërimit si magjistratë pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës.

Nisur jo vetëm nga mungesa e zbatimit të ligjit në mënyrë të saktë nga ILDKPKI por dhe nga nevoja për t'ja nënshtruar edhe një herë vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 9049/2003 nga ILDKPKI në ndryshimet e reja ligjore të vitit 2016, u parashikua që vlerësimin përfundimtar mbi saktësinë e raportit të përgatitur nga ILDKPKI të bëhet nga KLGJ për kandidatët për gjyqtarë dhe nga KLP për kandidatët për prokurorë.

Fatkeqësisht për shkak të një praktike shumë të shkurtër rreth 6 mujore, por akoma më shumë për shkak të mungesës së vullnetit të ILDKPKI-së për t'u njohur dhe për të përvetësuar jurisprudencën/standartet e KLGJ-së mbi interpretimin e ligjit nr. 9049/2003 si organ epror, vendimet (interpretimi) i të cilit është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga ILDKPKI sa i përket kriterit të pasurisë.

Aktualisht për shkaqet e sipërpermendura, interpretimit të gabuar dhe moszbatimit të interpretimit të ligjit në mënyrë të saktë nga ILDKPKI (sipas standartit/interpretimit përfundimtar të vendosur nga KLGJ), ka sjellë si pasojë ekzistencën e një gjendje paligjshmërie si rezultat i përgatitjes së një raporti me konkluzione të pabazuara në të vërtetën objektive dhe në ligj.

Bazuar dhe në shpjegimet/objeksionet pararendëse, në sa është paraqitur sa më sipër, dokumentacionin që shoqëron deklaratën e pasurisë dhe interesave private dhe dokumentet e paraqitura pranë KLGJ-së (kopje e të cilave janë percjellë ILDKPKI ), provohet se deklarami

është i saktë dhe në përputhje me ligjin duke plotësuar të gjitha kërkesat ligjore të parashikuara nga Ligji nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar dhe për të cilën në përfundim të procedimit administrativ ILDKPKI në zbatim të saktë të ligjit duhet të konkludonte se deklarimi është:

- ✓ I saktë dhe në përputhje me ligjin;
- ✓ Pasuria (rreth 1.738.000 leke ) objekt i ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar është/rrjedh nga burime të ligjshme;
- ✓ Nuk kam kryer fshehje të pasurisë;
- ✓ Nuk kam kryer deklaram të rremë;
- ✓ Nuk gjendem në kushtet e konfliktit të interesit.

Duke shpresuar në një interpretim të saktë të ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve Publikë”, i ndryshuar, mbetem shpreseplotë se sa i përket verifikimit të kriterit të pasurisë do ta konsideroni të kaluar me sukses.”

3. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

3.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me shkresën nr. 12592/1 prot., datë 08.07.2019, ku për kandidatin {...} nuk ka të dhëna për aktivitet tregtar.

3.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me shkresën nr. 16911/1 prot., datë 12.07.2019, ku për kandidatin {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

4. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t’ju kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

5. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të skualifikimit të tij nga kandidimi përse i përket kriterit të pasurisë, në referim të gërmës “a”, pika 4 e nenit 32 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pikës 20 të Seksionit “A” të Kreut IX të vendimit nr. 75, datë 23.05.2019 të KLGJ-së “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë.

- **Në lidhje me gjetjen e parë:** Mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar deklaramin e kandidatit për bashkëpjesëmarrje të prindërve në investimin në Bono Thesari, pasi nga sa është paraqitur dhe konfirmuar nga bankat, rezulton vetën në emër të {...}.
- Në deklaratën e pasurisë, tek deklarimi i të ardhurave, rezulton që, kandidati ndër të tjera të ketë deklaruar: të ardhura neto nga blerja e bonove të thesarit nga **një llogari e përbashkët në shumën 1.100.000 total**, pjesa ime prej 600.000 lekë të investuara në bono thesari. Shuma 40.514,3 lekë.

- Lidhur me këtë deklaram, Banka e Shqipërisë, me shkresën nr.46/1a prot, datë 11.07.2019, konfirmon se kandidati {...}, ka hapur llogari cash/titujsh për blerjen e bonove të thesarit, nr. {...}, me afat 1 vjekar, datë emetimi 15.03.2012 dhe maturimi 15.03.2013, në vlerën nominale 1.100.000 lekë, çmimi i blerjes 1.024.972 lekë, interesi në shumën 75.028 lekë.
- Kandidati ka paraqitur statement nga Banka e Shqipërisë, datë 02.07.2019, për Bonot e Thesarit në emër të {...}, për periudhën nga data 08.01.2008 deri në datën 08.05.2019, sipas së cilës {...} ka blerë bono thesari në datë 12.03.2012 në shumën 1.100.000 lekë dhe në datë 15.03.2013 është tërhequr shuma, interesi i përfituar 66.524 lekë (duke zbritur tatimin dhe komisionin).
- Në këto kushte, ILDKPI ka konstatuar se ka mungesë *dokumentacioni ligjor për të justifikuar deklaramin e kandidatit për bashkëpjesëmarrje të prindërve në investimin në Bono Thehari, pasi nga sa është paraqitur dhe konfirmuar nga bankat, rezulton vetëm në emër të {...}*.
- Lidhur me këtë konstatim, në shpjegimet e tij, kandidati ka sqaruar se burimi i pjesës së mbetur prej 500.000 lekë nga investimi në Bono Thehari është i prindërve të tij, nga të ardhurat familjare. Ai ka depozituar një deklaratë noteriale me nr. {...} rep, nr. {...} kol, datë 02.09.2019, nga e cila rezulton se për shumën prej 500.000 lekë kanë qenë bashkëpjesëmarrje e prindërve në blerjen e bonove të thesarit në vitin 2012. Ai ka sqaruar se duke mos qenë i familjarizuar me deklaramin dhe rrethanat në të cilat është bërë deklarami, ka deklaruar pjesën e tij të kontributit në bonot e thesarit prej 600.000 lekësh, duke mos i dhënë rëndësi pjesës së bashkëpjesëmarrësve të tjerë, të cilët janë prindërit e tij dhe burimi i pjesës së mbetur prej 500.000 lekë janë totalisht nga të ardhurat e prindërve dhe blerja është bërë përmes llogarisë së kandidatit për arsye se shuma duhet të ishte sa më e madhe në mënyrë që të pranohej kërkesa për blerjen e bonove të thesarit si edhe për shkak të kohës së disponueshme dhe njohurive të tij mbi këtë proces.
  - ❖ *Në analizë të këtij konstatimi, rezulton se në rastin konkret, bazuar në të dhënat e evidentuara, kandidati ka bërë deklaram jo të saktë, në kuptim të gërmës “a” të pikës 4 të nenit 32 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi nuk ekziston dokumentacion ligjor që të provojë deklaramin e kandidatit për bashkëpjesëmarrje të prindërve në investimin në Bono Thehari, pasi nga sa është paraqitur dhe konfirmuar nga bankat, rezulton vetëm në emër të {...}*.
- *Në lidhje me gjetjen e dytë: Mbetet i padokumentuar qëllimi i përdorimit të shumës prej 2.500.000 lekë, të kredituar nga shtetasi {...} (babai) në llogarinë e kandidatit {...}, i cili ka sqaruar se është përdorur për shpenzime të ndryshme, jo asete. Kandidati nuk është i sigurtë nëse është përdorur ose jo për dhënie huaje.*
- Banka Raiffeisen, me shkresat nr.46/2 prot, datë 09.07.2019 dhe datë 11.07.2019, konfirmon se kandidati {...}, ka llogari rrjedhëse në lekë, me nr. 3685905, çelur më datë 14.06.2013, me gjendje datë 05.07.2019, në shumën 0 lekë.

- Nga transaksionet në këtë llogari evidentohen se më **datë 18.06.2015** është kredituar shuma prej 2.500.000 lekësh nga babai i kandidatit, {...} me përshkrimin “Kalim në llogari të djalit”. Në datën 19.06.2015 është tërhequr nga llogaria shuma prej 2.000.000 lekësh me përshkrimin “tërheqje nga llogaria për shpenzime personale” si dhe po në këtë datë është tërhequr shuma prej 500.000 lekë, duke tërhequr në total shumën 2.500.000 lekë në datën **19.06.2015**.
- Gjithashtu ka rezultuar se më datë **19.06.2015**, (në të njëjtën datë që është tërhequr shuma e kredituar nga shtetasi {...}) është lidhur kontrata e huasë me nr. 1717 rep, nr. 1126 kol, datë 19.06.2015, me palë huadhënëse {...}, palë huamarrëse (debitorë solidarë) {...} etj me objekt dhënie huaje në shumën 20.000 euro, me afat kthimi të shumës deri në datën 18.06.2017.
- Lidhur me këto fakte, kandidati ka sqaruar se shuma prej 2.500.000 lekësh është kredituar nga shtetasi {...} (babai) në llogarinë e kandidatit {...} dhe është përdorur për shpenzime të ndryshme (jo asete), të padokumentuara dhe kandidati saktëson se nuk është përdorur për dhënie huaje por për konsum. Lidhur me huanë e dhënë nga kandidati shtetasve {...} etj më datë 19.06.2015, sqaroi se kjo hua është likjuar dhe se si burim kanë qenë të ardhurat e vëllezërve dhe motrës, emigrantë në Angli.
- Në procesverbalin e datës 19.09.2019, kandidati {...} dha shpjegime sa i përket dokumentimit të kontributit të vëllezërve dhe motrës në emigracion. Përsa i përket burimit të krijimit për kreditimin e shumës 2.500.000 lekë nga babai, shumës 20.000 euro dhënë hua shtetasve {...} etj, theksoi se burimi ka qenë nga vëllezërit dhe motra në emigracion në Angli. Lidhur me dokumentacionin ligjor justifikues për të ardhurat e vëllezërve dhe motrës në emigracion, kandidati është shprehur se e kishte të pamundur të siguronte dokumentacionin në një kohë kaq të shkurtër. Ai ka deklaruar gjithashtu se vëllezërit {...} dhe {...} kanë emigruar në mënyrë të paligjshme e në këto kushte të ardhurat e tyre nuk mund të dokumentohen. Ndërsa për vëllezërit {...}, {...} dhe motrën {...} deklaroi se ata kanë ndryshuar identitet dhe nuk identifikohet dokumentacioni ligjor i të ardhurave. Gjithashtu ai deklaroi se transferimi i të ardhurave është bërë cash.
  - ❖ *Në analizë të kësaj gjetje, të të dhënave që u evidentuan dhe deklarimeve të kandidatit, rezulton se në rastin konkret, nuk ka dokumentacion justifikues ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së kredituar nga babai prej 2.500.000 lekësh si dhe të shumës prej 20.000 euro dhënë hua shtetasve {...} etj, burim i cili sipas deklarimeve të kandidatit lidhet me të ardhurat e dërguara nga vëllezërit dhe motra, emigrantë në Angli. Në këto kushte, në rastin konkret, ndodhemi para mungesës së burimeve financiare të ligjshme, në kuptim të një prej rasteve të parashikuara në gërmën “a”, të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*
- *Në lidhje me gjetjen e tretë: Mospërputhje e burimit financiar të shtetasit {...} për dhënien e huasë shtetasit {...} në datë 08.01.2016 në shumën 4.255.000 lekë, konfirmuar nga DPPP nga puna në ndërtim e huadhënësit, ndërsa referuar kandidatit është nga aktiviteti i tij blegtoral dhe shitja e tokës dhe kafshëve të imta. Mungesë dokumentacioni lidhur me burimin financiar të huadhënësit.*



- DPPP, me shkresën nr. 46/26 prot, datë 15.07.2019, konfirmon akt noterial, nr.13 rep, nr.8 kol, datë 08.01.2016, kontratë, me këto të dhëna: pala huadhënëse {...}, palë huamarrëse {...}; lloji i kontratës: hua e zakonshme; objekti; dhënie e një huaje me këste gjatë viteve të kaluara; shuma e përfshirë në transaksion; 4.255.000 lekë; burimi i deklaruar: Nga kursimet gjatë punës në ndërtim nga viti 1990.
- Në procesverbalin e mbajtur më datë 19.09.2019, kandidati ka sqaruar se huaja në shumën 4.255.000 lekë, nga shtetasi {...}, është marrë në intervale kohe të ndryshme, përpara datës 08.01.2016. për burimin e krijimit theksoi se shtetasi {...} nuk disponon dokumentacion ligjor justifikues në kohën që ka patur aktivitetin në fshat, pasi në atë zonë përse i përket regjistrimit të pasurive edhe sot nuk është bërë regjistrimi fillestar e jo më në vitet 1990-2000 kur ka patur aktivitetin subjekti në fjalë.
- Në këto kushte ILDKPI ka konstatuar: *Mospërputhje e burimit financiar të shtetasit {...} për dhënien e huasë shtetasit {...} në datë 08.01.2016 në shumën 4.255.000 lekë, konfirmuar nga DPPP nga puna në ndërtim e huadhënësit, ndërsa referuar kandidatit është nga aktiviteti i tij blegtoral dhe shitja e tokës dhe kafshëve të imta. **Mungesë dokumentacioni lidhur me burimin financiar të huadhënësit.***
  - ❖ *Në analizë të kësaj gjetje, të të dhënave që u evidentuan dhe deklaramëve të kandidatit, rezulton se në rastin konkret, ka deklarim të pasaktë dhe mospërputhje të deklaramëve lidhur me burimin financiar të shtetasit {...} si dhe mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor për të provuar burimin e ligjshëm financiar të huadhënësit. Në këto kushte, në rastin konkret, ndodhemi para deklaramit jo të saktë dhe para mungesës së burimeve financiare të ligjshme, në kuptim të gërmës “a”, të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.*
- *Në lidhje me gjetjen e katërt: Mosparaqitje e dokumentacionit të plotë justifikues ligjor për burimin financiar të vëllezërve dhe motrës në emigracion (përvec të ardhurave nga paga e tij dhe e babait) që ka shërbyer për transaksione të kryera prej kandidatit për shpenzime e huadhënie.*
- DPPP, me shkresën nr.46/26 prot, datë 15.07.2019 konfirmon: - raportime bankare “{...} në datën 19.06.2015 ka tërhequr nga llogaria përkatësisht shumat 500.000 lekë dhe 2.000.000 lekë, me përshkrimin “shpenzime personale”, në bankën Raiffeisen. Konfirmon se po në këtë datë, {...} ka dhënë hua shumën 20.000 euro, shtetasve {...} etj; - konfirmon kontratë me palët e përfshira në transaksion: pala deklaruese {...} dhe {...} me objekt “dhënie borxhi”, shuma e përfshirë në transaksion 32.000 euro, burimi i deklaruar kursime nga kontratë huaje.
- Në ILDKPI është administruar deklaratë noteriale nr.28 rep, 13 kol, datë 12.01.2016, me palë deklaruese {...}, {...} dhe {...}, ku {...} deklaroi se i detyrohet shtetasit {...} një borxh në shumën 32.000 euro, të cilën e ka marrë cash për arsye personale.
- Nga dokumentacioni i paraqitur dhe përgjigjet e institucioneve rezulton se gjatë viteve 2013-2016 nga kandidati janë marrë hua gjithsej **7.365.000 lekë** dhe janë dhënë hua në total 57.800 euro, konvertuar rreth **9.000.000 lekë**. Të ardhurat e ligjshme deri në

dorëzimin e deklaratës janë rreth **3.791.000 lekë**. Shpenzime të konsumit familjar janë rreth **1.688.000 lekë**.

- Në procesverbalin e datës 19.09.2019, kandidati {...} ka dhënë shpjegime sa i përket dokumentimit të kontributit të prindërve, vëllezërve dhe motrës në emigracion. Përsa i përket burimit të krijimit për kreditimin e shumës 2.500.000 lekë nga babai, shumës 20.000 euro dhënë hua shtetasve {...} etj, theksoi se burimi ka qenë nga vëllezërit dhe motra në emigracion në Angli. Lidhur me dokumentacionin ligjor justifikues për të ardhurat e vëllezërve dhe motrës në emigracion, kandidati është shprehur se e kishte të pamundur të siguronte dokumentacionin në një kohë kaq të shkurtër. Ai ka deklaruar gjithashtu se vëllezërit {...} dhe {...} kanë emigruar në mënyrë të paligjshme e në këto kushte të ardhurat e tyre nuk mund të dokumentohen. Ndërsa për vëllezërit {...}, {...} dhe motrën deklaroi se ata kanë ndryshuar identitetet dhe nuk identifikohet dokumentacioni ligjor i të ardhurave. Gjithashtu ai deklaroi se transferimi i të ardhurave është bërë cash.
- Në këto kushte ILDKPI ka konstatuar: *Mosparaqitje e dokumentacionit të plotë justifikues ligjor për burimin financiar të vëllezërve dhe motrës në emigracion (përvec të ardhurave nga paga e tij dhe e babait) që ka shërbyer për transaksione të kryera prej kandidatit për shpenzime e huadhënie.*

❖ *Në analizë të kësaj gjetje, të të dhënave që u evidentuan dhe deklarimeve të kandidatit, rezulton se në rastin konkret, nuk ka dokumentacion justifikues ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të shumave të parave që kanë shërbyer për transaksionet e kryera prej kandidatit për shpenzime e huadhënie, burim i cili sipas deklarimeve të kandidatit lidhet me të ardhurat e dërguara nga vëllezërit dhe motra, emigrantë në Angli. Në këto kushte, në rastin konkret, ndodhemi para mungesës së burimeve financiare të ligjshme, në kuptim të një prej rasteve të parashikuara në gërmën “a”, të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*

5.1 Bazuar sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor, arrin në përfundimin se përsa i përket verifikimit të kriterit të pasurisë, në rastin konkret rezulton se kandidati {...} nuk arriti të kalojë me sukses këtë moment, për shkak të deklarimit jo të saktë dhe mungesës së dokumentacionit justifikues ligjor lidhur me pasurinë, siç u analizua më sipër, në referim të gërmës “a”, të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

5.2 Neni 32/4/a i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se: “Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magjistraturës kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve..”

### **C. Për kriterin e figurës sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit**

1. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

2. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk është ngritur ende.

3. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo aktivitete të kundërligjshme.

4. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe ai plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 17.06.2019, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

4.1 Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës, duke përcjellë në Këshill, me shkresën nr. 1782/261 prot., datë 18.09.2019, Vendimin “Për miratimin e rezultateve të verifikimit”, sipas të cilit është vlerësuar se “*Subjekti deklarues {...}, kandidat për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.*

4.1.1 Në këtë vendim, përveç përfundimit të sipërcituar, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme se për subjektin {...}, kjo prokurori, ka regjistruar **kallëzimin penal nr. {...}, datë 28.08.2013**, për të cilin kjo prokurori ka vendosur mosfillimin e procedimit penal; **kallëzimin penal nr. {...}, datë 30.07.2014** dhe **kallëzimin penal nr. {...}, datë 05.02.2019**, për të cilët është vendosur gjithashtu mosfillimi i procedimit penal.

4.1.2 Duke marrë shkas nga këto të dhëna, u kërkua informacion më i detajuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 20.09.2019. Nga informacioni i paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me datë 17.10.2019, rezultoi se :

- *Me datë 23.08.2013 ka bërë kallzim penal shtetasi {...} ndaj shtetasit {...} për kryerjen e veprës penale “Kanosja” parashikuar nga neni 84 i K.Penal.  
Me datë 28.08.2013 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur regjistrimin e procedimit penal dhe pas veprimeve hetimore të kryera me datë 02.09.2013 ka vendosur: Mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallzimin nr. {...} datë 28.08.2013 pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.*
- *Me datë 23.07.2014 ka bërë kallzim penal shtetasja {...} ndaj djalit të saj, shtetasit {...} për kryerjen e veprës penale “Dhuna në familje” parashikuar nga neni 130/a i K.Penal.*

*Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë pas veprimeve hetimore të kryera me datë 01.12.2014 ka vendosur : Mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallzimin nr. {...} datë 30.07.2014.*

- *Me datë 30.01.2019 ka bërë kallzim penal shtetasi {...} ndaj shtetasit {...} për kryerjen e veprës penale “Kanosja” parashikuar nga neni 84 i K.Penal.  
Me datë 05.02.2019 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë pas veprimeve hetimore të kryera ka vendosur : Mosfillimin e procedimit penal për akuzën “Kanosja” në materialin kallzues nr. 1676 datë 05.02.2019.*

4.1.3 Duke marrë shkak nga fakti që shtetësja {...}, nëna e kandidatit, kishte bërë kallzim penal me datë 23.07.2014, ndaj shtetasit {...}, djali i saj, për veprën penale “Dhuna në familje”, u kërkua informacion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me faktin nëse shtetësja {...} **kishte paraqitur padi për lëshim urdhër mbrojtje përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë** dhe nëse po, vënia në dispozicion e kopjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Nga informacioni i paraqitur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me datë 22.10.2019, rezultoi se shtetësja {...}, kishte paraqitur më datë 23.07.2014, padinë me objekt “lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes” ndaj shtetasit {...}.

- o Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë **me vendimin datë 26.07.2014** ka vendosur mbi lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes për paditësen, shtetasen {...} kundër djalit të saj, shtetasit {...}.
- o Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë **me vendimin nr. {...} datë 30.07.2014** në seancën e vërtetimit të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes nr. 12976 akti, datë 26.07.2014 ka vendosur : Pushimin e gjykimit të çështjes për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse {...} pa shkak të arsyeshëm, për rrjedhojë ndërprerjen e efekteve të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar nga kjo gjykatë.

4.1.4 Gjithashtu, nga aktet që lidhen me një nga kallzimet e bëra ndaj kandidatit, z. {...}, ka rezultuar se z. {...} ka deklaruar para oficerit të policisë gjyqësore më datë 26.08.2019, pas kallzimit të shtetasit Skënder Imeraj, se punonte jurist në Ministrinë e Jashtme.

Lidhur me këtë fakt, z. {...} është pyetur nga relatorja, pasi ky fakt punësimi nuk rezultonte në dokumentet që provojnë marrëdhëniet e punësimit të kandidatit dhe në emailin e datës 21.10.2019 është përgjigjur se: “*Ju informoj se asnjëherë nuk kam qenë i punësuar pranë Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Madje, nuk kam qenë asnjëherë as fizikisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Duke qenë se është një institucion Buxhetor kjo mund të verifikohet shumë lehtë përmes korrespondencës zyrtare.*”

3.2 Në vijim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit të z. {...}, për t’u pranuar në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, bazuar në të dhënat e evidentuara në aktet që lidhen me vendimet e sipërcituara të Prokurorisë së Shkallës së Parë Tiranë për mosfillim procedimi penal, vendosi të njoftojë kandidatin {...}, **për gjetjen e kësaj procedure në lidhje me verifikimin e figurës dhe integritetit të kandidatit, në kuptim të nenit 32 në lidhje me nenin 3 dhe 4 të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”** dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë*”, duke konsideruar gjetje lidhur me figurën dhe integritetin e kandidatit, faktet si më poshtë:

- Më datë 23.07.2014, shtetësja {...} (nëna e kandidatit z. {...}), ka bërë kallzim ndaj kandidatit, z. {...}, për shkak të një konflikti që kanë pasur. Rezulton se lidhur me këtë kallzim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e datës 01.12.2014 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për shkak se sipas akuzës nuk ka rezultuar që nga veprimet e tij të ketë elementë të ekzistencës së veprës penale të *“Dhunës në familje”* për shkak se nuk ka pasur kontakt fizik midis tij dhe nënës së tij por vetëm fjalë fyese. ***Nga përmbajtja e deklarimeve të dhëna nga nëna dhe babai i kandidatit, evidentohen të dhëna që vënë në dyshim sjelljen etike dhe integritetin moral të kandidatit.*** Në deklarin e datës 23.07.2014, nëna e kandidatit deklaroi se: *“ Më datë 22.07.2014, rreth orës 23.30, djali im {...}, ka dalë jashtë banesë dhe në oborrin e banesës këputi prizën e korentit të pompës së ujit dhe për këtë unë i thashë se përse e bërë këtë gjë. Unë në atë moment isha në katin e dytë tek dera e banesës sime dhe pas këtyre fjalëve, djali im {...} ka marrë në dorë një levë hekuri dhe u ngjiti me vrap nëpër shkallë në drejtimin tim...”*
- Gjatë verifikimit ka rezultuar gjithashtu se bazuar në të njëjtat fakte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 24.07.2014 ka vendosur lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes kundër të paditurit {...}, pasi ***gjykata ka konstatuar që paditësjë {...} është shumë e traumatizuar nga veprimet dhe kërcënimet e të paditurit {...}.***
- Gjithashtu gjatë verifikimit ka rezultuar se ndaj kandidatit, z. {...}, ka bërë kallzim shtetasi {...} për kanosjen që ka pretenduar t'i ketë shkaktuar ky shtetas. Rezulton që lidhur me këtë kallzim është vendosur mosfillimi i procedimit penal me vendimin e datës 18.02.2019 nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për shkak se nuk është konkluduar për ekzistencë të veprës penale të *“Kanosjes”*. Në kallzimin e tij shtetasi {...} ka deklaruar se kishte një marrëdhënie qeraje me z. {...} dhe për shkak se ai nuk ka qenë korrekt në pagesa për 4 muaj, e ka kontaktuar në telefon dhe e ka kërcënuar, i ka bërë presion dhe ai duke u ndjerë i kërcënuar e i frikësuar ka bërë kallzim ndaj kandidatit z. {...}. Ndërkohë, pas kallzimit, sipas deklarimeve të kandidatit të datës 12.02.2019 dhe sipas deklarimeve të shtetasit {...} të po kësaj date, rezulton që detyrimet e qerasë janë shlyer dhe marrëdhëniet janë normalizuar.
- Gjatë verifikimit ka rezultuar se ndaj kandidatit {...} ka paraqitur kallzim edhe shtetasi {...}, për të cilin gjithashtu është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 02.09.2013, në të cilin argumentohet se: *“ Në rastin objekt hetimi, veprimi që ka kryer i kallzuari nuk përmbush kushtet për tu konsideruar si formë kanosje pasi nuk mund t'i krijojë bindjen personit se nga momenti në moment jeta apo shëndeti i tij mund të jenë në rrezik serioz. Kërcënimi verbal i kryer nga i kallzuari nuk mjafton që të konsiderohet e konsumuar vepra penale, pasi duke mos konstatuar prezencën e ndonjë arme apo mjete tjetër të fortë, nuk mund të konkludohet se kanosja ka qenë serioze, e tillë që të krijonte bindjen e realizimit të atypëratyshëm të veprës së kanosur.”*

Në kallzimin e tij shtetasi {...} ka deklaruar se ka marrë një kërcënim me jetë ditën e kallzimit, nga kandidati z. {...} bashkë me dy persona të tjerë, për shkak të një borxhi që vajza e tij kishte ndaj z. {...}. Fakti i njohjes së këtij shtetasi si dhe i kontaktit me të si dhe ekzistenca e huasë dhënë shtetasës {...} është pohuar dhe nga ana e z. {...} në përgjigjen e datës 25.10.2019.

- Vlen të theksohet se pavarësisht faktit që në të gjitha rastet është vendosur mosfillimi i procedimit penal, nga vendimet përkatëse të prokurorisë dhe aktet që lidhen me kallzimet respektive, *evidentohen të dhëna lidhur me veprime fyese dhe kërcënuese nga ana e kandidatit z. {...} ndaj personave që kanë paraqitur kallzim, të cilat vënë në diskutim sjelljen etike dhe integritetin e tij moral, në cilësinë e kandidatit për gjyqtar, cilësi të cilat, në kuptim të nenit 3 dhe 4 të ligjit nr.96.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” janë thelbësore me qëllim forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.*
- Ka rezultuar gjithashtu, se z. {...} ka deklaruar para oficerit të policisë gjyqësore më datë 26.08.2019, pas kallzimit të shtetasit {...}, se punonte jurist në Ministrinë e Jashtme.  
Lidhur me këtë fakt, z. {...} është pyetur nga relatorja pasi ky fakt punësimi nuk rezultonte në dokumentet që provojnë marrëdhëniet e punësimit të kandidatit dhe në emailin e datës 21.10.2019 është përgjigjur se: *“Ju informoj se asnjëherë nuk kam qenë i punësuar pranë Ministrisë së Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Madje, nuk kam qenë asnjëherë as fizikisht në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë. Duke qenë se është një institucion Buxhetor kjo mund të verifikohet shumë lehtë përmes korrespondencës zyrtare.”*
- Këto pohime kontradiktore, në këtë fazë të procesit të verifikimit të këtij kandidati, vlerësohen të tilla, që çënojnë integritetin moral, sjelljen etike dhe korrekte që duhet të karakterizojë figurën e kandidatit për gjyqtar.

4.2.1 Më datë 30.10.2019, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Kreu IX, Seksionin A, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua :

- për vendimin e gjetjes, vendim ky që i është bashkëngjitur njoftimit;
- për të drejtën që kishte për të paraqitur shpjegime dhe dokumenta të tjera përpara Këshillit, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

4.3. Me datë 05.11.2019, kandidati, z. {...}, depozitoi pretendimet e tij lidhur me gjetjet e kriterit të figures dhe integritetit duke argumentuar si më poshtë :

### **1. Lidhur me kallzimin e datës 23.07.2013, nga shtetësja {...};**

*1.1 Shtetësja {...} (nëna) duke mos qenë me njohuri ligjore (për shkak të arsimimit vetëm 8 vjeçar), ka pasur si qëllim që të kërkojë urdhër mbrojtje dhe jo të bënte një kallzim penal për dhunë në familje. Nisur nga mungesa e njohurive ligjore, oficeri i policisë gjyqësore i ka kërkuar që të nënshkruante një kërkesë, (për shkak të paaftësisë së saj për të kuptuar çështjet e ligjit) por nuk ka mundur që të lexojë se akti që ka nënshkruar ka qenë kallzim penal dhe që mund të sillte pasoja të ndryshme nga ato që ajo kishte paramenduar, (të cilat gjithsesi ishin në abuzim të ligjit).*

*Qellimi i saj ka qenë vetëm kërkesë për marrjen e një urdhër mbrojtje nga gjykata sepse sipas vlerësimit të saj mund t'i shërbente për arritjen e qëllimit të saj, (qëllim i cili do sqarohet më poshtë).*

*Siç dhe evidentohet edhe në korrespondencën e mëparshme ne jemi një familje prej rreth 8 anëtarësh dhe deri në fillim të vitit 2019, ekonominë e kemi pasur dhe administruar në mënyrë të përbashkët, pavarësisht se kush i siguronte të ardhurat. Nisur nga fakti që*

pothuajse gjithë të ardhurat siguroheshin nga vëllezërit dhe motra në emigracion, shpenzimeve jo të vogla (sipas vlerësimit të prindërve) që unë bëja, kanë arritur në vendimin që banesa private (ndërtim informal) e ndërtuar me kontributin e vëllezërve dhe motrës në emigracion t'u lihej vetëm vëllezërve dhe motrës dhe unë mos të kisha asnjë pjesë në atë banesë.

Ndodhur përpara faktit që unë kisha në posedim/përdorim në atë kohë (jo sot) një kat të banesës private dhe nuk isha dakort me vendimin e prindërve për të hequr dorë nga kjo banesë, shtetësja {...} ka arritur në konkluzionin se duhej përdorur çdo mjet që unë të detyroheshja që të hiqja dorë nga shtëpia.

Për këtë arsye ajo ka menduar se duke më paditur mua (kështu e kuptonte ajo), nga frika unë do detyroheshja që të hiqja dorë nga banesa dhe t'i bindesha vendimit të prindërve dhe kështu ajo do ju lihej në dospozicion të familjarëve të tjerë (vëllezërve dhe motrës).

## 1.2. Lidhur me urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes;

Së pari është urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes dhe duke qenë se ai lëshohet nga gjykata pa praninë e palëve, në këto raste gjykata është në rolin e noterit më shumë se gjykatës dhe fatkeqësisht e lëshon atë në çdo rast që i vjen një kërkesë sepse duke qënë një gjykim vetëm mbi aktet nuk ka sesi të verifikojë realisht gjendjen e faktit nëse ajo realisht është ashtu siç pretendohet nga pala iniciuese e kërkesës apo jo.

Së dyti ligji duke pasur parasysh se mund të abuzohet me këtë kërkesë ka parashikuar seancën e vlerësimit/konfirmimit të urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes, përmes së cilës gjykata është në gjendje që të vijë në dijeni të së vertetës objektive të konfliktit dhe të faktit nëse pretenduesi/kërkuesi është në abuzim të ligjit, pra ka qëllime të tjera apo realisht është përpara gjendjes faktike kur duhet lëshuar një urdhër mbrojtjeje.

Në përfundim të shqyrtimit gjykata ka vendosur të refuzojë, të mos konfirmojë lëshimin e urdhërit të menjëhershëm të mbrojtjes. Ky refuzim heq me efekte prapavepruese edhe urdhërin e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar prej saj për shkak se nuk i verifikon kushtet me ekzistencën e të cilave mund të lëshohet urdhëri i menjëhershëm i mbrojtjes. Duke mos u konfirmuar urdhëri i menjëhershëm i mbrojtjes konsiderohet se nuk është lëshuar asnjëherë.

Së treti urdhëri i mbrojtjes është një lloj mase preventive/parandaluese me natyrë civile dhe që në thelb ska asgjë më shumë se ndërgjegjësim të palëve (jo çdo shtetas është jurist) se sjellje të caktuara janë të ndaluara nga ligji dhe në thelb synon të sensibilizojë subjektet e përfshira në konflikt mbi të drejtat e njëri-tjetrit. Duket qartë që këtu jemi përpara një rasti të abuzimit me ligjin nga kërkuesi për të arritur qëllimet e përmendura më sipër.

## 2. Lidhur me Kallezimin në shkurt të vitit 2019 nga shtetasi {...};

Me shtetasin në fjalë kemi pasur për njëfarë kohe një marrëdhënie qeraje për një banesë. Kemi pasur mosdakortësi pothuaj për gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëdhënies së qerasë, për shumë çështje që lidheshin me shtëpinë. Kjo për shkak se nuk përmbushte aspak detyrimet që bazuar në ligj ka qiradhënësi. Duke ardhur në dijeni se me datë 31.01.2019, KLGJ ka shpallur vendet e lira për aplikim në Shkollën e Magjistraturës (profili gjyqtar) dhe duke ditur se kisha interes për të marrë pjesë në provim, duke përfutuar nga rasti që i është dhënë duke abuzuar me ligjin, për të më shkaktuar mua probleme, (sepse sipas tij nëse unë të bëj kallzim penal ty s'të pranojnë në konkurs por do të përjashtojnë nga pjesmarrja në konkurs), ka sajuar gjoja se une e kam marrë në telefon dhe ai është ndier i frikësuar. Në fakt telefonata mund të ketë ndodhur, por sbesoj se ka pasur ndonjë ndryshim nga dhjetëra telefonata të tjera të zhvilluara gjatë muajve më perpara sesa telefonata e pretenduar prej tij

se e ka shqetësuar apo tronditur shumë. Ky është një rast i abuzimit me ligji nga shtetasi {...} dhe padyshim nuk ka dhënë të gjitha qëllimet që priste ai (pasi ai shpresonte që duke bërë kallzim ndaj meje të më pamundësonte rregjistrimin në Shkollën e Magjistraturës për të marrë pjesë në provimin pranues), por ka arritur një pjesë, sepse qoftë dhe këto shpjegime para KLGJ-së, për këtë kallzim janë arritje e një pjese të qëllimit të tij (për të më dëmtuar mua), kur ka bërë kallzimin gjoja se ishte i shqetësuar nga fjalët e përdorura apo toni i zërit nga ana ime. Gjithsesi ky është një rast ku shtetasi {...} ka abuzuar me ligjin, fakt të cilin ka konstatuar dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Përpyetje të tilla të personave dashakeq që synojnë të abuzojnë me ligjin nuk duhen toleruar nga KLGJ, pasi kjo jo vetëm cënon të drejtat e subjektit viktimë (të mia në rastin konkret), por edhe për shkak të interferencës së personave të tretë duke ndërhyrë në proces në mënyrë të kundraligjshme, pamundësojnë edhe KLGJ-në në ushtrimin e kompetencës së vlerësimit me objektivitet të funksioneve të veta.

### **3. Kallzimi në gusht të vitit 2013, nga shtetasi {...};**

Siç evidentohet edhe nga sjellja e mëpasme e shtetasis {...} së bashku me vajzën e tij rezulton se ka qenë një plan i mirëorganizuar në bashkëpunim për të më mashtruar. Fakti i kallzimit penal ka qenë mjeti/apo opsioni i fundit që ata kanë përdorur në mënyrë që mashtrimin ta çojnë deri në fund dhe me qëllim final që mos të më kthejnë detyrimin që kanë ndaj meje. Pretendimet e shtetasis {...} janë pretendime dhe si të tilla ngelin, ato nuk janë provuar dhe për aq kohë sa nuk janë provuar nuk kanë asnjë vlerë juridike. Në këtë konstatim ka arritur edhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila ka vendosur se nuk ka elementë të veprës penale të pretenduar.

### **4. Deklarimi përpara oficerit të policisë gjyqësore se jam punonjës i Minsitrisë së Jashtme;**

Unë nuk kam informacion se ku është bërë një deklaratë e tillë, për shkak se nuk kisha mundësi që të merrja kopje të dosjes së prokurorisë brenda së cilës gjenden aktet por duke marrë të mirëqënë verifikimin e saktë për kryerjen e këtij deklarimi nga ana ime në vitin 2013. Besoj se duhet të ketë qenë lapsusi i mbajtësit të deklarimit dhe mungesë vëmendje nga ana ime për të kontrolluar saktësinë e procesverbalit ose duke mos e vënë re redaktimin e pasaktë duhet të kem firmosur deklaratimet pa i dhënë rëndësinë e duhur ose vetë oficeri i policisë gjyqësore mundet që me keqbesim të ketë futur pjesë në procesverbal që nuk janë thëniet e mia duke synuar me keqbesim të më vendosë para deklaratimeve të pasakta në formë por gjithsesi të sakta në substancë/thelb. Një deklarami i tillë nuk ka sjellur asnjë pasojë të dëmshme përveçse tregon një mungesë vëmendje nga ana ime në një moment të caktuar kur duhet t'i kisha dhënë me shumë rëndësi.

Referuar njoftimit tuaj mbi gjetjet për figurën pretendohet se lidhur me kallzimet e bëra ndaj meje se : “evidentohen të dhëna lidhur me veprime fyese dhe kërcënuese nga ana juaj ndaj personave që kanë paraqitur kallzim, të cilat vënë në diskutim sjelljen etike dhe integritetin tuaj moral, në cilësinë e kandidatit për gjyqtar, cilësi të cilat, në kuptim të nenit 3 dhe 4 të ligjit nr. 96.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” janë thelbësore me qëllim forcimin e besimit të publikut të sistemit të drejtësisë.”

**Parashtroj se** nuk evidentohen të dhëna por evidentohen pretendime për veprime fyese dhe/ose kërcënuese. Dallimi është shumë i qartë ndërmjet të dhënave dhe pretendimit se ka pasur të dhëna të tilla. Nga materialet hetimore evidentohen vetëm pretendime. Nëse ato pretendime të ngritura nga kallzuesit do të vërtetoheshin atëherë do ktheheshin në të dhëna



dhe për rrjedhojë do ishim përpara disponimeve të tjera nga ana e prokurorisë, duke vlerësuar se ka vend për konsum të veprës penale të pretenduar nga kallzuesit dhe për rrjedhojë dërgimin e çështjes në gjykatë. Ndodhur përpara faktit se pretendimet kane qënë pa asnjë bazë dhe abuzive prej kallzuesve vetë prokuroria ka vlerësuar se nuk jemi përpara elementëve, jo të veprës penale por as të pretendimeve të qënësishme se mund të ketë edhe një minimum dyshimi se mund të kenë ndodhur rrethana të pretenduara prej kallzuesit në secilin rast.

Dhe duke qënë pretendime çdokush është i lirë të pretendojë, se ndihet i fyer nga një sjellje e caktuar, i frikësuar nga një gjest apo sjellje e caktuar, apo i kanosur nga një gjest apo sjellje e caktuar, dikush mund të pretendojë se ndihet i kërcënuar nga toni i zërit tuaj, dikush tjetër mund të ketë qëllime krejt të tjera dhe duke abuzuar me të drejtën që i jep ligji për të bërë një kallzim e bën atë vetëm për t'i prishur imazhin tjetrit, duke shpresuar të ndikojë qoftë edhe në karrierën profesionale në të ardhmen. Të gjitha këto pretendime kanë marrë përgjigje ligjore në mënyrën e parashikuar nga ligji dhe në përfundim në çdo rast është vendosur mosfillimi i procedimit penal për shkak se pretendimet e pretenduara (vepra penale), nuk rezultojnë të ekzistojnë.

Aq më tepër që në rastin konkret evidentohet qartë që pretendimi i vënë në themel të kallzimit është sajuar nga shtetësja në fjalë {...} për qëllimet e sipërcituara. Për qëllime tërësisht të paligjshme janë bërë edhe dy kallzimet e tjera, përkatësisht nga shetetasi {...} dhe {...} (referoju më lart qëllimeve reale për të cilat kanë bërë kallzimet përkatëse)

Si neni 3, po ashtu dhe neni 4, në thelb synojnë që të vendosin disa standarte në sjelljen e magjistratit duke synuar që të ftojnë magjistratin për një dilijencë të shtuar si në veprimtarinë që ushtron si magjistratë, ashtu edhe në veprimtarinë që kryen kur nuk ushtron funksionet zyrtare, por në asnjë rast ato nuk vendosin detyrim mbi kandidatin e ardhshëm që kohë më parë se të bëhej kandidat të respektonte këto parashikime ligjore (të cilat nuk ekzistonin) dhe aq më pak të kishte aftësinë të parashikonte të ardhmen e tij se një ditë mund të bëhej kandidat për magjistrat.

Këto cilësi parashikueshmërie, jo vetëm që nuk i ka asnjë njeri i zakonshëm, por as janë kërkesë e ligjit dhe aq më tepër çenojnë thellësisht parimin e sigurisë juridike sepse një interpretim i tillë do ta vendoste subjektin (mua) përpara përgjegjësisë ligjore pse skam pasur aftësinë për të parashikuar që një ditë do bëhesha kandidat për magjistrat në të ardhmen dhe aq më tepër pse skam pasur aftësinë që të parashikoj që një ditë të caktuar të vitit 2016 do miratohej një ligj i ri (96/2016) me standarte krejt të tjera nga legjislacioni paraardhës (ligji Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë i vitit 2008).

### **Reflektimi personal mbi ngjarjet e së shkuarës dhe mbi të ardhmen;**

Në lidhje me kallzimin e kryer nga {...} (nëna), pavarësisht krizës së madhe në marrëdhëniet ndërmjet nesh pas këtij gjesti të kryer prej saj (pavarësisht vendimit të gabuar për përdorjen e kallzimit/kërkesë për lëshim urdhër mbrojtje, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve rreth pronësisë së shtëpisë private), duke pasur parasysh pasojat serioze që sillte mbi mua kjo situatë ka sjellë një periudhë disa mujore që kemi pasur një komunikim të vështirë.

Por në vijim duke e justifikuar me mungesën e njohurive deri në paaftësinë për të lexuar e kuptuar çfarë ka firmosur para opgj-së kur ka dorëzuar kërkesën, e kam justifikuar gjithnjë e më shumë dhe sot kemi marrëdhënie normale njëri me tjetrin. Duke pasur parasysh se të gjithë vëllezërit dhe motra janë me banim në Mbreterinë e Bashkuar dhe faktin se prindërit

*sot jetojnë vetëm në shtëpi në Shqipëri jam përpjekur që gjatë kësaj kohë t'i bëj ta ndiejnë sa më pak që të jetë e mundur mungesën e tyre, duke qënë prezent jo vetëm sa më takon mua por duke u përpjekur që të plotësojë edhe mungesën e vëllezërve të tjerë dhe motrës.*

*Sa i përket kallzimeve të kryera nga shtetas të tjerë, gjatë kësaj kohe kam kuptuar se pavarësisht se mbi statusin ligjor të personit ndikon vetëm vendimi i formës së prerë i gjykatës që të shpallë të fajshëm, gjithsesi shumë, shumë konflikte, mosmarrëveshje apo kontradikta të ndryshme për çfarëdolloj arsyeje mundet dhe duhet të bëhen përpjekje maksimale;*

*së pari për t'i shmangur;*

*së dyti për t'i zgjidhur në mënyrën sa më të mirë të mundshme;*

*së treti mos të neglizhohen deri në vajtjen për zgjidhje përpara organeve shtetërore.*

*Përpjekja për t'i zgjidhur konfliktet/mosmarrëveshjet duhet detyrimisht të paraprihet nga një kujdes i shtuar në mënyrë që komunikimi me individë të ndryshëm të jetë më i kujdesshëm qoftë edhe duke menduar paraprakisht se niveli natyral i zërit, tonit mundet që ndokush edhe ta keqkuptojë dhe të frikësohet kur në fakt nuk ka asnjë arsye dhe aq më pak një qëllim të tillë nga ana ime.*

*Sa i përket deklarimeve para oficerit të policisë gjyqësore, rreth pasaktësive/gabimeve materiale të konstatuara, mendoj se sot më shumë se kurrë më përpara duke pasur parasysh edhe funksionet e gjyqtarit do duhet në çdo rast dhe në çdo rrethanë që çdo akt qoftë edhe një fletëhirrje e gjykatës, para nënshkrimit do duhet të ketë kujdesin maksimal në çdo rast, që të verifikohet nëse të dhënat e pasqyruara janë të sakta.*

*Bazuar në sa më sipër, kallzimet ndaj meje, kërkesa për urdhër të menjëhershëm mbrojtje, dhe deklarata para oficerit të policisë gjyqësore (referuara më lart), nuk çënojnë kriteret dhe kushtet që unë duhet të plotësoj bazuar në parashikimet e ligjit nr. 96.2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 28 e vijues. Diligjenca apo detyrimi për t'u kujdesur për aq sa parashikon neni 3 dhe 4 i ligjit për statusin, nuk shtrihen përpara marrjes së cilësisë së magjistratit dhe në çdo rast kurrsesi përpara marrjes së cilësisë së kandidatit për magjistrat.*

*Duke shpresuar për një interpretim të saktë të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", mbetem shpresëplotë se sa i përket kandidaturës sime do ta vlerësoni se plotëson të gjitha kriteret e ligjit të sipërpërmendur."*

4.4 Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor çmon se janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të skualifikimit të tij nga kandidimi përse i përket kriterit të figurës, etikës dhe integritetit të tij, në referim në kuptim të nenit 32/4/c të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në lidhje me nenin 3 dhe 4 të po këtij ligji.

4.4.1 Këshilli vlerëson se, nga përmbajtja e të dhënave të sipërcituara, ka një problematikë në lidhje me kriterin e figurës dhe kjo jo në të gjithë komponentët që përfshihen nën këtë kriter në kuptim të nenit 32 të Ligjit të Statusit. Në vlerësim të Këshillit, në kuptim të verifikimit të kriterit të figurës së kandidatit, objekt verifikimi dhe vlerësimi për pranueshmërinë ose jo të

një kandidati për në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magistraturës është edhe etika dhe morali në çdo sjellje të evidentuar në të kaluarën e tij, për të cilat Këshilli ka për detyrë të verifikojë dhe vlerësojë nëse ato janë në përputhje me vlerat themelore të një magistrati, standartet etike dhe rregullat e sjelljes, të përcaktuara këto në nenet 3 dhe 4 të Ligjit të Statusit.

4.4.2 Konkretisht, sipas nenit 32, pika 4, të Ligjit të Statusit, *“Në çdo rast, kandidati nuk pranohet në Shkollën e Magistraturës kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”*.

Ndërsa sipas nenit 3 të Ligjit të Statusit, ku parashikohen vlerat themelore të magistratit, ndër të tjera përcaktohet se: *“3. Magistrati nuk duhet të krijojë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhet të ndikohet nga pushteti ekzekutiv ose nga pushteti legjislativ. ... 4. Magistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime. 5. Sjellja e magistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbytje dhe mature”*.

Kurse sipas nenit 4 të Ligjit të Statusit, ku parashikohen standartet e etikës dhe rregullat e sjelljes, ndër të tjera përcaktohet se: *“1. Magistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. 2. Magistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standartet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; ...”*.

4.4.3 Në analizë dhe vlerësim të rasteve të evidentuara gjatë verifikimit të figurës së kandidatit, konstatohen veprimet e kandidatit ndaj të tretëve, përfshirë dhe ndaj nënës së moshuar, që konsistojnë në kërcënimet verbale të tij, kërcënime këto të bëra për motive të dobëta dhe qëllime aspak të ligjshme. Fakti që nga organi i ndjekjes penale, sjellja e kandidatit në ato raste nuk është cilësuar dhe kualifikuar si vepër penale, nuk do të thotë se në sjelljen e tij nuk gjenden elementë të një sjelljeje në kundërshtim të hapur me normat e moralit shoqëror dhe, aq me tepër, me standartet etike dhe morale të magistratit, detyrë që kandidati synon të arrije duke kandiduar për në programin e formimit fillestar në Shkollën e Magistraturës.

**4.4.4 Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi vlerësoi sjelljen etike të kandidatit, bazuar në të dhënat e konstatuara dhe verifikuara gjatë procesit të verifikimit, çmon se ajo nuk është në**

*përputhje me vlerat themelore të një magjistrati, standartet etike dhe rregullat e sjelljes, të përcaktuara këto në nenet 3 dhe 4 të Ligjit të Statusit e në këto kushte konkludohet për papranueshmërinë e ndjekjes nga ai të programit të formimit fillestar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës.*

4.5. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me shkresën nr. 5655/1 prot., datë 19.08.2019, ka dërguar në Këshill të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

4.5.1 Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

5. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të skualifikimit të tij. Konkretisht, verifikohet që :

- a) *Kandidati ka plotësuar, depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;*
- b) *kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;*
- c) *për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;*
- ç) *për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;*
- d) *për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;*

*dh) për kandidatin ka të dhëna të tjera të atilla në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilat të mund të konkludohet për papranueshmërinë e ndjekjes nga ai të programit të formimit fillestar për magistrat në Shkollën e Magjistraturës, pasi evidentohet ekzistenca e shkaqeve të tjera përjashtuese, lidhur me figurën, etikën dhe integritetin moral të kandidatit, në kuptim të nenit 32/4/c të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në lidhje me nenin 3 dhe 4 të po këtij ligji.*

### **III. KONKLUZIONE**

1. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

2. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati nuk përmbush këto kriterë, që janë shkak për skualifikimin e tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për skualifikimin e kandidatit për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në nenin 32, pika 4, shkronjat “a” dhe “c”, dhe pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor

### **VENDOSI:**

1. Skualifikimin e kandidatit z. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magistrat, profili gjyqtar.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**